



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR

**VERIFKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT
NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN BASHKIAK SHKODËR, NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 08.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për Këshillin Bashkiak Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Nr . 255 i vendimit Data 08 .05.2019 e vendimit Ora 10:00 e vendimit



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për Këshillin Bashkiak Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Këshilli i Bashkisë Shkodër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Këshill, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të njërit prej anëtarëve.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar z. Lush Kol Marku, përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Lush Kol Marku, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2723 prot., datë 06.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2721 prot., datë 06.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak, z. Lush Kol Marku, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V- 1329/1 prot., datë 07.05.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar në Këshillin Bashkiak Shkodër, sipas të cilës rezulton se z. Lush Kol Marku, është i padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli bashkiak ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar kreut V paragrafi i fundit, pikës 2, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për kandidatin për këshilltarë bashkie, të dhënat e të cilës nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli bashkiak përkatës dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme për verifikim.

Nr . 255 i vendimit Data 08 .05.2019 e vendimit Ora 10:00 e vendimit



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për Këshillin Bashkiak Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Njoftimin e Këshillit Bashkiak Shkodër, për vazhdimin e procedurave, për dhënien e mandatit kandidatit të listës shumemërore të subjektit politik, Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Lush Kol Marku, për plotësimin e vendit vakant në këshillin bashkiak.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

Nr . 255 i vendimit Data 08 .05.2019 e vendimit Ora 10:00 e vendimit



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për Këshillin Bashkiak Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"